NR. 15, MAJ 2023 | Viti II
Revistë e përmuajshme (politike-diplomatike)

# ARGUMENTUM

news opinion analysis



## G7 me 5 mesazhe madhore gjeopolitike!

-Kina hap "rrugën drejt paqes" në Ukrainë

-Zgjedhjet vendore/ PS merr 53 bashki. Koalicioni "Bashkë Fitojmë" merr vetëm 7 bashki në total

- NATO to send 700 more troops to Kosovo to help quell violent protests

ARGUMENTUM
news opinion analysis

**Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,**

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.
Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.
Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.
**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpuntorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.
Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

**“Argumentum”, një proces intelektual ...**

**Marjana DODA**
**Kryeredaktore**

# Përmbajtja


**03 OP/ED**
- G-7 me 5 mesazhe G-7 me 5 mesazhe madhore gjeopolitike!
- Kina hap “rrugën drejt paqes” në Ukrainë

**10 EDITORIAL**
- Dëbimi i miliona refugjatëve nga Turqia, Kemal Kiliçdaroglu kryen “vetëvrasje politike”

**12 POLITIKË**
- Zgjedhjet vendore/ PS merr 53 bashki. Koalicioni “Bashkë Fitojmë” merr vetëm 7 bashki në total
- Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj jep dorëheqjen

**15 JO VETEM LAJM**
- Si e humbi Biden Ballkanin
- *100-vjetori i Komunitetit Mysliman Shqiptar/* Presidenti Begaj: Bashkësia Islame e Shqipërisë kontribuese për Pavarësinë e Shqipërisë dhe gur konsolidues të shtetit Shqiptar

**17 FOKUS**
- Kryeministri Rama dhe Ambasadorja e SHBA-së Kim marrin pjesë në nisjen e stërvitjes ushtarake “Defender Europe 2023”

**20 RAJONI**
- Tensionet në veri të Kosovës, BE: Të dyja palët përgjegjëse për dhunën. Dialogu është më i rëndësishëm se kurrë
*Dështon përpjekja për një takim Kurti-Vuçiç në Bratislavë*
- BE pret që Mali i Zi të fokusohet në reformat drejt integrimit

***ENGLISH EDITION***

**23 REALPOLITIK**
- “Class reading” in Brussels!! Long live the King! Zelenski opens up, Putin isolated! “Political tremor in Tirana but not in Turkey!

**26 ENGLISH TOP NEWS**
- NATO soldiers clash with Serb protesters in Kosovo, Russian FM warns a big explosion is looming in the heart of Europe
- Rama calls for an end of the threatening absurdity in the north of Kosovo

**28 IN FOCUS**
- Defense Minister gives details on “Defender Europe ’23” taking place in 5 military bases in Albania

**29 BALKAN OVERVIEW**
- NATO to send 700 more troops to Kosovo to help quell violent protests

# G-7 ME 5 MESAZHE MADHORE GJEOPOLITIKE!




DR. JORGJI KOTE

Pa kurrfarë teprimi dhe për disa arsye madhore gjeopolitike që do te shtjellohen me poshtë, Kryeministri japonez Kishido e quajti "historik" Samitin e G-7 në Hiroshima, më 19 – 21 Maj. Ky Samit, më i rëndësishmi për Japoninë në gati 5 dekadat e fundit u bë historik me pesë mesazhe madhore gjeopolitike me "rreze të gjatë veprimi". Le të jemi më konkretë.

Së pari, liderët e G-7 u mblodhën në Hiroshima, qytetin me 1,1 milion banorë që u shkatërrua i tëri nga bomba atomike që hodhën SHBA-të më 6 Gusht 1945. Mbas bombardimit të tij dhe të Nagasakit tri ditë më vonë, Japonia kapitulloi pa kushte. Mirëpo, në kushtet e tanishme të përshkallëzimit të kërcënimeve bërthamore vështirë se mund të kishte vend tjetër më të përshtatshëm për këtë Samit. Hiroshima na rikujton të gjithëve tmerret dhe pasojat e tragjike që vijojnë nga përdorimi i armëve atom-

ike. Ca më tepër që çarmatimi bërthamor, megjithë premtimet dhe përbetimet në këto 20 vitet e fundit ka mbetur iluzion dhe retorikë politike. Përshkallëzimi i garës së armatimit bërthamor ka kapur nivele të frikshme, duke ia kaluar dhe periudhave më kritike të Luftës së Ftohtë. Aktualisht, kemi përshkallëzim bërthamor në atë zonë tejet delikate nga Kina, Korea e Veriut, e cila ka lëshuar disa raketa balistike dhe pranë Hiroshimës si dhe Irani në Lindjen e Mesme.

Ndaj natyrshëm Samiti përcolli mesazhin e parë madhor të popullsisë atje që e ka pësuar më rëndë se kushdo tjetër për çarmatim, për pengimin e përshkallëzimit të garës bërthamore. Këtë e kërkuan paraprakisht dhe 8200 Kryebashkiakët që i janë bashkuar nismës së Hiroshimës" Bashkiakët për paqe" Ashtu siç dhe pritej, kjo temë me ndjeshmëri të jashtëzakonshme zuri vendin e vet në deklaratën përfundimtare. Edhe pse, siç pohojnë analistët dhe ekspertët politikë, armatimi bërthamor vazhdon të "jetë në krye të axhendës" dhe në vendet perendimore. Madje, tashmë nevoja për këtë armatim përbën thelbin e doktrinës mbrojtëse të NATO-s, Japonisë dhe vendeve të tjera të mëdha. Për pasojë, çështja që u shtrua ishte shmangia e përshkallëzimit të mëtejshëm dhe forcimi i kontrollit mbi mospërhapjen e armëve bërthamore. Sepse dhe gjatë vitit 2022, për të tetin vit rradhazi shpenzimet përkatëse kapën shifrën rekord prej 2,24 trilion Euro. Së fundi problemi është të shmanget harresa historike. Këtij qëllimi i shërbyen dhe vizitat e 7 liderëve botërorë në të vetmen strukturë të mbetur nga bomba e viit 1945, tashmë Muzeu i Paqes, në Obeliskun me emrat e të gjithë viktimave në Hiroshima dhe me mbylljen ceremoniale të Samitit aty te Parku i Paqes.

Mesazhi i dytë historik nga Hiroshima ishte mbështetja e palëkundur dhe e pakufizuar për Ukrainën, "për aq kohë sa do të jetë e nevojshme", duke nënkuptuar dhe një luftë të gjatë për të fituar mbi agresorin rus. 15 muaj mbas këtij agresioni të pajustifikuar dhe të paprovokuar, aleanca perendimore ndodhet në një fazë tejet kritike, kundër ofensivës ukrainase dhe çlirimin e plotë i territorit të saj, pa asnjë pretendim për të depërtuar në tokën ruse. Në Hiroshima, Perendimi rikonfirmoi vazhdimin e paketave të tjera të mëdha me ndihma financiare, ekonomike dhe ushtarake. Prania e Presidentit ukrainas, Zelenski, i konsideruar si "ylli" i samitit në vizitën e tij më të rëndësishme jashtë vendit i nxiti liderët e "shtatëshes" që ta zgjidhin dhe më shumë "qesen" e premtimeve. Kështu, mikpritësja, Japonia i dhuroi 7,6 miliard Euro; SHBA-të i premtuan 375 milionë Dollarë të tjera ndihma me armatime, municione dhe mjete të blinduara, ndërsa Berlini i dha disa ditë më parë në prag të këtij samiti 2,7 miliard Euro. Por, në Hiroshima u kalua në një fazë dhe më të avancuar në drejtim të mbështetjes ushtarake të Ukrainës. Presidenti amerikan deklaroi se Perëndimi më në fund do ta furnizojë Ukrainën me avionat superefektivë F -16. Pas tankeve të sofistikuar "Leopard II" dhe Abrams", livrimi i F – 16 pas disa muajsh dhe trainimit të pilotëve ukrainas do të rrisë ndjeshëm aftësitë ushtarake ukrainase në tokë, në ajër, në forcën goditëse, duke siguruar epërsi shkatërruese ndaj Rusisë. Kësisoj, në Hiroshima u krijua "Aleanca e avionëve" e cila pritet të konkretizohet shpejt. Në botë ka gjithsejt 2800 avionë F – 16, dhe NATO me një numër të madh. Mesazhi në Hiroshima ishte se Ukraina duhet dhe do ta fitojë me çdo kusht këtë luftë; kjo jo vetëm për të mbrojtur një vend dhe aleat të Perëndimit, por dhe "forcën e të drejtës" ndërkombëtare kundër "të drejtës së forcës", vlerat dhe parimet demokratike, të drejtën e popujve dhe vendeve për sovranitet, për mbrojtjen e rendit ndërkombëtar nga ndryshimet me dhunë dhe me armë.

> ”
> **Prania e Presidentit ukrainas, Zelenski, i konsideruar si "ylli" i samitit në vizitën e tij më të rëndësishme jashtë vendit i nxiti liderët e "shtatëshes" që ta zgjidhin dhe më shumë "qesen" e premtimeve. Kështu, mikpritësja, Japonia i dhuroi 7,6 miliard Euro; SHBA-të i premtuan 375 milionë Dollarë të tjera ndihma me armatime, municione dhe mjete të blinduara, ndërsa Berlini i dha disa ditë më parë në prag të këtij samiti 2,7 miliard Euro.**

Mesazhi i tretë i rëndësishëm madhor ishte shtrëngimi i mëte-



jshëm i darës së sanksioneve dhe më të ashpra ekonomike ndaj Rusisë, që ajo të mos jetë në gjendje të financojë luftën në Ukrainë. Gjatë këtij samiti u ra dakord që këto sanksione të prekin dhe eksportin rus të metaleve të çmuara dhe diamantëve, për të cilat Rusia është prodhuesi dhe eksportuesi më i madh në botë. Sfida është e madhe dhe për BE-në, mbasi tregu më i madh në botë është qyteti port i Anversës në Belgjikë, ku tregtohet 85 për qind të diamantit rus, nga i cili 40 për qind i përpunuar. Ndërkohë, krahas SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe, BE-ja ka pothuajse gati paketën e 11-të të sanksioneve ekonomike, ku do të ndëshkohen dhe 30 kompani të huaja dhe mbi 300 persona që kanë ndihmuar Rusinë në përballimin e masave të mëparshme.

Mesazhi i katërt gjeopolitik po aq i rëndësishëm lidhet me qëndrimet e ardhëshme perendimore ndaj Kinës. Ndryshimi i madh në këtë drejtim është kërkesë ulëritëse mbas ashpërsimit të retorikës dhe veprimeve politike, ekonomike dhe ushtarake, praktikave të saj të njëanshme, pa transparencë, duke përfituar nga varësia e madhe ekonomike perendimore nga mallrat dhe lëndët e para strategjike kineze. Ndërkohë, që vazhdon me kërcënimet ndaj Tajvanit, me provokime në Detin e Kinës Jugore dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në Tibet dhe me Ujgurët, të cilat u kritikuan me force në këtë Samit. Në fakt, si Perëndimi dhe Kina akuzojnë njera tjetrën për masat shtrënguese, trysni dhe shantazhe ekonomike dhe ushtarake. Ndërkohë, që ka patur e ka disa nuanca dhe mospërputhje qëndrimesh midis aleatëve perendimorë deri në mendime për ndarjen ose shkëputjen e Kinës nga ekonomia botërore.

Në fakt, Samiti në Hiroshima ishte historik dhe sepse për herë të parë Perëndimi u shpreh me një qëndrim të përbashkët mbi Kinën. Ajo u përcaktua si partnere, rivale dhe konkurente. Përkundrejt akuzave kineze dhe një gjuhe më të ashpër të mëparshme, liderët e G7 u treguan më të moderuar në formulimin e qëndrimeve të tyre. Ata u shprehën qartë dhe në deklaratën përfundimtare se nuk synojnë të dëmtojnë, frenojnë dhe pengojnë përparimin dhe

zhvillimin ekonomik të Kinës; as ta ndajnë apo shkëputin atë nga zhvillimi ekonomik botëror. Më tej, ata deklaruan se synojnë rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Kinën në shumë fusha me interes të përbashkët por dhe rritjen e qëndresës së tyre dhe kundërshtimin e veprimeve të dëmshme, minimizimin e rreziqeve dhe varësisë ekonomike nga lëndët e para kineze, zinxhirët e furnizimit me mallra dhe shumëllojshmërimin e industrive të tyre. Nga ana tjetër, G 7 i kërkoi Pekinit të shtojë trysninë e saj ndaj Rusisë, që ajo t'i japë fund luftës në Ukrainë.

Kina dhe Rusia përmenden 20 herë në deklaratën përfundimtare, tregues ky i theksit shumë më të madh që vendet e G7 i kushtuan këtyre dy vendeve.

Megjithatë, Pekini e priti "me këmbët e para" këtë deklaratë, duke e akuzuar G7 si një ‘ klikë" dhe 6 vendet e tjera si " marioneta" të SHBA-ve, që nga njera anë këndojnë këngë paqeje, por ndërkohë shtypin dhe nënshtrojnë të tjerët.

Mesazhi i pestë madhor historik ishte se për herë të parë u trajtua praktikisht zgjerimi i frontit të bashkuar perendimor global në mbështetje të Ukrainës dhe kundër agresionit rus. Fjala është për disa vende të mëdha demokratike si India, Brazili, Indonezia, etj të cilat ende nuk janë shrehur qartë dhe nuk u janë bashkuar sanksioneve ndaj Rusisë. Për këtë qëllim, në Hiroshima ishin ftuar dhe muarën pjesë Presidenti i Brazilit De Lula, Kryeministri indian Mody, etj. Natyrisht ky ishte hapi i parë që do të pasohet me të tjerë, duke përfshirë Organizatën e Unitetit Afrikan dhe grupime të tjera me peshë.

> ***Samiti në Hiroshima ishte historik dhe sepse për herë të parë Perëndimi u shpreh me një qëndrim të përbashkët mbi Kinën. Ajo u përcaktua si partnere, rivale dhe konkurente. Përkundrejt akuzave kineze dhe një gjuhe më të ashpër të mëparshme, liderët e G7 u treguan më të moderuar në formulimin e qëndrimeve të tyre. Ata u shprehën qartë dhe në deklaratën përfundimtare se nuk synojnë të dëmtojnë, frenojnë dhe pengojnë përparimin dhe zhvillimin ekonomik të Kinës; as ta ndajnë apo shkëputin atë nga zhvillimi ekonomik botëror.***

Ideja është zgjerimi i këtij bashkëpunimi në kuadrin e OKB-së, që këto 45 vende të lëkundura në Afrikë, dhe Amerikën Latine të bashkohen me aleancën perendimore. Veç të tjerash, kjo do të pengonte shumë mallra ruse të ndaluara të eksportohen nëpërmjet tyre në vende të tjera, duke zbehur efektivitetin e sanksioneve perendimore. Për disa shkaqe thelbësore, kjo përbën një sfidë të madhe sepse: disa prej këtyre vendeve hezitojnë me argumentin se lufta Rusi-Ukrainë është konflikt i brendshëm europian ku ato nuk ka pse të përzihen; të tjera kanë shumë interesa biznesi, si grupimi BRICS (Kina, Rusia, India, Brazili dhe Afrika e Jugut); ndërsa vende të ndryshme kanë lidhje tradicionale me Rusinë apo u besojnë fabulave ruse të viktimizimit.

Ndaj dhe liderët e G7 nënvizuan me të drejtë se agresioni rus ndaj Ukrainës nuk është konflikt i brendshëm europian, por shumë më i gjerë, se Perëndimi "ia ka dalë borxhit Rusisë" me të gjitha mjetet paqësore dhe diplomatike dhe nëse nuk krijohet një aleancë kundër tij, ky rrezik mund të përhapet dhe jashtë Europës, siç ndodhi dhe gjatë Luftës së II Botërore.

Lajmi i mirë këtu është sheshimi i mosmarrëveshjeve Japoni – Kore e Jugut dhe forcimi i partneritetit strategjik mes Seulit, BE-së dhe SHBA-ve. Kështu, fill mbas Hiroshimës, presidentet e BE-së von der Leyen dhe Charles Michel shkuan në Seul ku përcaktuan hartën rrugore të partneritetit të tyre strategjik.

Veç sa sipër, vendet e G7 e vunë theksin te zbatimi i nismës madhore "Global Gateway" sipas të cilës deri në vitin 2027 do të jepen 600 miliard Euro për vendet e prapambetura në Afrikë, Azi dhe Amerikën latine, shumica në formë grantesh. Ajo përbën një alternativë bindëse ndaj nismës sfiduese kineze "Një brez, një rrugë" me projekte gjigande infrastrukturore.

Ja pse Samiti i G7 në Hiroshima mund të cilësohet moment madhor i kthesës historike në qëndrimet dhe marrëdhëniet e deritanishme gjeopolitike prerendimore me Kinën, Rusinë, Ukrainën, çarmatimin bërthamor dhe sfida të tjera të vështira e të mëdha në Europë, Afrikë, Azi dhe Amerikën Latine.



MARJANA DODA

“

**Li Hui,** *Përfaqësuesi Special i Kinës për Çështjet Euroaziatike*

“Kina ndjek gjithmonë qëllimet dhe parimet e Kartës së OKB-së, mban një qëndrim objektiv dhe të drejtë dhe promovon në mënyrë aktive bisedimet e paqes. Kina gjithmonë bën gjykimin e saj në mënyrë të pavarur bazuar në meritat e çështjes. Kina qëndron gjithmonë në anën e paqes dhe dialogut dhe në anën e duhur të historisë”.

# Kina hap “rrugën drejt paqes” në Ukrainë

Turneu i Përfaqësuesit Special të Kinës për Çështjet Euroaziatike Li Hui, mbi krizën në Ukrainë përfundoi pas një udhëtimi gati dy-javor (nga 15 deri më 26 maji) nëpër Evropë duke përmbyllur hapin e parë e një misioni paqeje.

Li Hui, përfaqësuesi i posaçëm i qeverisë kineze për çështjet euroaziatike, u takua me liderë dhe diplomatë të lartë, duke shkëmbyer mendime mbi zgjidhjen politike të krizës në Ukrainë. Gjatë këtij udhëtimi që filloi më 15 maj, në Ukrainë, Poloni, Francë, Gjermani, seli e BE-së në Bruksel dhe Rusi u pa qartë se këto palë pranojnë rolin vendimtar të Kinës në promovimin e bisedimeve të paqes.

Kjo vizitë nisi pikërisht me Ukrainën, si vendi që sot po përjeton drejtpërdrejt pasojat e një konflikti të përgjakshëm ku i dërguari kinez theksoi nevojën e krijimit te kushteve për përfundimin e konfliktit dhe nxitjen e bisedimeve të paqes. Dhe u përmbyll me Rusinë, e cila me shumë se kurrë me parë gjendet në një izolim ndërkombëtar përballë këtij konflikti me Ukrainën.



Li Hui u takua me presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskyy dhe zhvilloi bisedime të veçanta me shefin e zyrës së Presidentit ukrainas Andriy Yermak, Ministrin e Jashtëm ukrainas Dmytro Kuleba dhe zyrtarë të ministrive ukrainase të infrastrukturës, energjisë dhe mbrojtjes.

Ukraina shprehu kënaqësinë e saj për pritjen e të dërguarit special të Kinës menjëherë pas bisedimeve

telefonike midis liderëve. Ai tha se i kushton rëndësi të madhe rolit të rëndësishëm të Kinës në çështjet ndërkombëtare si një anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe mirëpret rolin pozitiv të Kinës në përfundimin e konfliktit dhe rivendosjen e paqes.

"*Kina ndjek gjithmonë qëllimet dhe parimet e Kartës së OKB-së, mban një qëndrim objektiv dhe të drejtë dhe promovon në mënyrë aktive bisedimet e paqes. Kina gjithmonë bën gjykimin e saj në mënyrë të pavarur bazuar në meritat e çështjes. Kina qëndron gjithmonë në anën e paqes dhe dialogut dhe në anën e duhur të historisë*", tha Li Hui ndërsa zhvilloi bisedime me ministrin e Jashtëm rus Sergei Lavrov në Moskë.

Li Hui zhvilloi bisedime me zyrtare nga Polonia, Franca, Gjermnaia, Brukseli, si vende me role kyçe në Europë duke theksuar se Kina ka mbajtur gjithmonë një qëndrim objektiv dhe të paanshëm për çështjen e Ukrainës dhe promovon në mënyrë aktive bisedimet e paqes."

Kina mbështet forcimin e autonomisë strategjike të vendeve evropiane dhe përpjekjet për stabilitetin afatgjatë të kontinentit evropian", theksoi ai

Të gjitha këto vende mirëpritën rolin e Kinës për të lehtësuar dhe qetësuar tensionet aktuale dhe për të siguruar paqen sa më shpejt të jetë e mundur.

Franca e vlerëson shumë vizitën e Përfaqësuesit Special Li Hui dhe pret që Kina të vazhdojë rolin e saj konstruktiv në ndërprerjen e armiqësive.

Gjermania duke vlerësuar përpjekjet pozitive të Kinës për të de-përshkallëzuar krizën në Ukrainë, theksoi se është shumë e dobishme dhe e nevojshme që Gjermania dhe Kina të forcojnë dialogun për një sërë çështjesh kryesore ndërkombëtare dhe rajonale, duke përfshirë çështjen e Ukrainës.

Zyrtarët e BE-së, gjithashtu folën mirë për rolin pozitiv që Kina luajti në zgjidhjen paqësore të konfliktit dhe thanë se vlerësojnë parimet në dokumentin që përshkruan pozicionin e Kinës për zgjidhjen politike të krizës në Ukrainë. BE ndan shumë interesa të përbashkëta në lidhje me çështjen e Ukrainës me Kinën.

Por këto takime të të dërguarit kinez dhe kjo iniciativë e Kinës për të te ecur drejt rrugës së paqes nuk është pritur nga të gjitha po aq mirë sa në Europë.

Madje në mediat ndërkombëtare perëndimore raportimet rreth këtij turneu ishin të veshura me një tis dyshimi.

The Wall Street Journal raportoi se "Një zyrtar Perëndimor që di bisedimet midis ambasadorit kinez dhe qeverive europiane" bëri të ditur se, Kina propozoi një plan të ndalimin e zjarrit, duke pranuar që Rusia të zërë tokën e Ukrainës të pushtuar. Për këtë, kryediplomati ukrainas Dmytro Kuleba publikoi më 27 maj një video në Facebook, duke e hedhur poshtë.

"Kam kontaktuar menjëherë kolegët e mi në kryeqytetet e vizituara (Li) dhe të gjithë ata konfirmuan se nuk kishte pasur bisedime apo negociata për njohjen si Rusi të atyre territoreve (ajo aktualisht kontrollon) në Ukrainë", tha Kuleba në një video-mesazh në faqen zyrtare Facebook.

"Askush nuk do të bëjë asgjë kundër nesh pas shpinës së Ukrainës, sepse ne kemi ndërtuar marrëdhënie besimi me të gjithë partnerët tanë kryesorë", shtoi ai.

Turneu evropian i të dërguarit të posaçëm ndonëse dëshmoi se roli i Kinës në promovimin e paqes është i pranuar gjerësisht, sërish perëndimi vijon këtë propagandë kundër qasjes së Kinës për zgjidhjen e këtij konflikti.

Që në krye të herës, sapo Kina shpalosi, qëndrimin e saj me 12 pika, për konfliktin Rusi-Ukrainë, me propozime konkrete, menjëherë u gjendem para një furie skepticizmi, dizinformimi që vinin nga çdo front, politik, social, mediatik nga vendet perëndimore.

Nuk është e habitshme se çdo propozim që vjen nga Kina, apo nga një vend tjetër përveçse nga vendet perëndimore shihet me një pikëpyetje të madhe e me prapavije të rrezikshme.

Është e kuptueshme deri diku pasi çdo shtet kërkon të mbrojë interesat e veta politike dhe primatin në arenën globale.

Megjithatë, në këndvështrimin tim, ndërsa jemi para një lufte faktike prej 16 muajsh , me humbje të mëdha njerëzore, ekonomike dhe me një deficit të madh politik, them se nuk ka vend për skepticizëm apo mosbesim nga çdo iniciative paqeje pavarësisht se nga vjen ajo.

Fatkeqësisht edhe pse nisma e saj e paqes për t'i dhënë fund luftës ruso-ukrainase, ka marrë tashmë rrugën e saj, tentohet të minohet kjo rruge kineze e paqes.

Duhet ta theksojmë se ky turne në Europë nga emisari kinez është për të gjetur "shtegun" drejt paqes.

Që do të thotë se Kina nëpërmjet këtij udhëtimi me disa ndalesa të rëndësishme, së pari ishte për të bërë të qartë pozicionin dhe propozimet e saj, por dhe të dëgjojë mendimet dhe këshillat e palëve të ndryshme dhe të ndërtojë mirëkuptime të përbashkëta ndërkombëtare. Pra, ajo në këtë faze nuk ishte përcaktuese për kushtet e paqes por dëgjuese, udhërrëfyese, e këshilluese, çka përbëjnë hapat e pare për një rrugë të sigurt drejt paqes.

Kjo vizitë e Përfaqësuesit Special Li Hui, u mirëprit dhe u mbështet, qoftë nga protagonistët e kësaj krize, por dhe të gjitha palët e interesuara për ti dhënë fund këtij konflikti në Europë.

Asgjë nuk është rastësore. Kina e ka

treguar me ndërmarrjen e hapave të njëpasnjëshëm qasjen e saj për një zgjidhje paqësore të kësaj krize.

Në përvjetorin e parë të luftës Rusi-Ukrainë, Kina publikoi një propozim prej 12 pikash për paqen – "*Pozicioni i Kinës për Zgjidhjen Politike të Krizës së Ukrainës*" – që u prit me skepticizëm në kryeqytetet perëndimore duke pasur parasysh lidhjet e Pekinit me Rusinë.

Por që nga biseda telefonike e Xi-Zelenskyy, disa liderë evropianë, duke përfshirë presidentin francez Emmanuel Macron dhe Presidenten e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen, kanë udhëtuar në Pekin dhe i kanë kërkuar Kinës që të luajë një rol më aktiv në frenimin e veprimeve të Moskës.

Ndaj kjo përpjekje për paqe e Kinës është nxitur dhe nga vetë liderit europiane që besojnë dhe inkurajojnë Kinën si vendi që mund të ndërmjetësojë paqen mes Rusisë dhe Ukrainës.

Kujtojmë se Presidenti francez Emmanuel Macron i ka kërkuar homologut të tij kinez Xi Jinping që të përdorë ndikimin e tij për të ndihmuar në ndalimin e luftës së Rusisë në Ukrainë.

"Unë e di se mund të mbështetem tek ju për ta sjellë Rusinë në vete," i tha ai Xi në fillim të bisedimeve në Pekin.

Por ndërsa Pekini ka treguar se mbetet neutral ndaj luftës, pozicionimi i tij i ngushtë me Rusinë kanë ngritur gjithashtu pikëpyetje mbi qëllimet që qëndrojnë pas shtytjes së saj për paqe.

Një qasje absurde dhe e pavend duke marrë parasysh se pikërisht kjo marrëdhënie miqesore mes Kinës dhe Rusisë është dhe një garanci se Rusia ka besim te Kina si ndërmjetësuese.

Si përpjekjet e para praktike paqësore diplomatike të Kinës për të ndihmuar në zgjidhjen e krizës në Ukrainë, vizita e Li tregon edhe një herë qëllimin themelor të Kinës për një zgjidhje paqësore të konfliktit Rusi-Ukrainë dhe tregon qëndrimin konsistent të Kinës si një vend kryesor në botë.

"Kina do të vazhdojë të luajë një rol konstruktiv dhe të ndërtojë më shumë konsensus ndërkombëtar për përfundimin e armiqësive, fillimin e bisedimeve të paqes dhe parandalimin e përshkallëzimit të situatës".

Kujtojmë se Pekini më parë shmangu përfshirjen në konfliktet midis vendeve të tjera, Kina organizoi bisedime midis Arabisë Saudite dhe Iranit në mars që i çoi ata në rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike pas një ndërprerjeje shtatëvjeçare, dhe gjithashtu së fundit ka folur dhe për mundësinë e ndërmjetësimit midis Izraelit dhe Palestinës.

**"Më shumë thirrje për armë se sa për paqe"**

Që nga pushtimi rus i Ukrainës më 24 shkurt, është folur për gjithçka përveçse për një zgjidhje diplomatike të luftës. Mbështetja dhe armatosja e Ukrainës, nuk është mënyra më e mirë për t'i dhënë fund konfliktit pasi armët nuk sjellin paqe.

Sigurisht konflikti Rusi-Ukrainë është konflikti më i madh i armatosur në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore, ku ka shkaktuar dëme dhe pasoja të pallogaritshme njerëzore, materiale dhe financiare; veç mijëra viktimave ushtarake e civile, janë zhvendosur 15.7 milionë ukrainas (8 milionë persona të zhvendosur brenda vendit dhe 7.7 milionë refugjatë).

Megjithatë sërish thirrja për më shumë armë nuk është zgjidhja përfundimtare për këtë konflikt. E nuk mund të jetë fitore as për Ukrainasit .

Që nga nisja e këtij konflikti, shtetet perëndimore i kanë ofruar armë dhe municione Ukrainës që të përballet me forcat ruse. Së fundmi, Uashingtoni është pajtuar që pilotët ukrainas të trajnohen për përdorimin e avionëve luftarakë F-16, por ende nuk është bërë e ditur nëse SHBA-ja do të dërgojë avionë të tillë në Kiev.

E ndërsa Ukraina vazhdimisht ka kërkuar avionë modernë luftarakë për t'iu kundërvënë dominimit në qiell që ka Rusia, si zgjidhja e vetme në këtë situatë, liderët evropianë i shohin ndryshe perspektivat e zgjidhjes, duke krijuar dhe përçarje mes tyre. Këto përçarje përkeqësohen nga dyzimi midis publikut perëndimor nëse qëllimi kryesor i politikës së vendit të tyre duhet të jetë nxitja për paqen ose vendosja e drejtësisë(!)

Shtetet e Bashkuara dhe aleatët që mbështesin Ukrainën kundër pushtimit të Rusisë, me sa duket kanë hequr dorë nga negociatat për t'i dhënë fund luftës. Gatishmëria e NATO-s për t'i ofruar Ukrainës armatime gjithnjë e më të avancuara, si artileria me rreze të gjatë, sistemet e mbrojtjes ajrore dhe tanket, largon çdo mundësi për tu ulur ne bisedime për ti dhënë fund kësaj agonie lufte.

Dërgesat e tyre të armëve dhe sanksionet gjithnjë e më të ashpra synojnë të gjunjëzojnë Moskën ushtarakisht dhe ekonomikisht. Në vend të kësaj, Pekini ka mbrojtur një zgjidhje diplomatike, siç u demonstrua me udhëtimin dy javor të dërguarit të posaçëm kinez në Europë.

Qasja kineze për paqe është e realizueshme. Bisedimet që çojnë në një zgjidhje të negociuar do t'i japin fund konfliktit më shpejt sesa ato të furnizimit me armë të cilët zgjasin luftimet .

Ndaj kjo rrugë paqësore e Kinës nuk duhet asesi të paragjykohet por të gjithë së bashku të vendosin qofte edhe një "gur" për ta shtruar këtë rrugë të fortë e të sigurt, me bindjen se armët nuk janë rruga drejt paqes, se lufta është një humbje e njerëzimit.

Ndaj në emër të njerëzimit, ndiqni rrugën e paqes!

# Dëbimi i miliona refugjatëve nga Turqia, Kemal Kiliçdaroglu kryen "vetëvrasje politike"



Kandidati presidencial i opozitës turke, Kemal Kiliçdaroglu, u zotua se do të dëbonte 10 milionë refugjatë nëse zgjidhej president i Turqisë, në balotazhin e 28 majit.

"Sapo të vij në pushtet, do t'i kthej të gjithë refugjatët në shtëpitë e tyre", tha Kiliçdaroglu, duke e cilësuar balotazhin si një çështje mbijetese për Turqinë.

"Nëse presidenti aktual Recep Tayyip Erdogan rizgjidhet, atëherë 10 milionë azilkërkues të tjerë do të mbërrijnë në Turqi", tha Kiliçdaroglu në një fjalim në Ankara.

Por zotimi i tij se do të dëbonte 10 milionë refugjatë nga Turqia, erdhi si një rrufe në qiell të hapur, një autogol për vetë Kiliçdaroglu vetëm pak ditë para votimit në balotazh.

Në këtë rast si një "rreze drite" për kundërshtarin Erdogan, i cili për herë të pare nuk arriti shumicën absolute të nevojshme për të fituar në raundin e parë zgjedhjet presidenciale.

Ndaj ky vendim i papritur nga Kiliçdargolu bën që sërish Erdogan të fitojë një tjetër mandat si president i Turqisë. Kujtojmë se Erdogan është vlerësuar nga BE dhe SHBA pikerisht për mbështetjen që ka dhënë duke u bërë stacion i refugjatëve nga Lindja.

Madje herë pas here Europa jo vetëm që e ka ndihmuar finaciarisht mbajtjen e miliona refugjateve siriane, por shpesh edhe ka mbyllur syte përpara veprimeve antidemokratike të Erdogan.

Disa here Erdogan, i ka përdorur refugjatet si një AS nën mëngë përballë Europës pasi e di se Turqia është shpetimi i vetëm i Europës.

Ndaj ky vendim i papritur nga kundërshtari poliitk Erdogan, se do të dëboje miliona refugjatë, pezmatoi zyrtarët e lartë Perëndimor, ndonëse ata hapur e kane mbështetur Kiliçdaroglu si një president i ardhshëm që mund ta rrëzojë Erdogan dhe Turqia të hapë një kapitull të ri.

Kiliçdargolu duket se bëri "vetëvrasje politike", ndonëse e beri kete për të fituar mbështetjen e popullit turk, ai dukshëm humbi mbështetjen ndërkombëtare.

Ndërsa jemi vetëm një javë nga balatozhi që do të përcaktojë se kush do ta fitoje këtë beteje politike, Erdogan tashmë beri një lëvizje diplomatike tejet të butë për një karakter shpërthyes e drejtpërdrejtë si Erdogan.

Ai nuk shenjestroi me gisht SHBA-të e as nuk akuzoi për tu vetëmbrojtur, ndryshe nga një javë më parë, ku gjatë një takimi elektoral në Stamboll, Erdogan tha se presidenti amerikan




po punon për largimin e tij nga pushteti. Biden dha urdhrin për të rrëzuar Erdoganin, unë e di këtë. Të gjithë njerëzit e mi e dinë këtë.

Tashmë vetëm pak dite para balotazhit, Erdogan zgjati dorën e bashkëpunimit me Shtëpinë e Bardhë, kushdo që të ishte Presidenti i saj, duke marrë parasysh se pas disa muajsh do të kemi zgjedhje presidenciale në SHBA.

Kështu, në një intervistë për CNN Presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, zgjodhi t'i shmangej pyetjes lidhur me një përpjekje të mundshme amerikane për ta larguar nga pushteti. I pyetur nëse beson se Uashingtoni po përpiqet ta rrëzojë atë, ai u përgjigj duke kritikuar presidentin amerikan Joe Biden se e shikon atë si diktator.

Si mund të jetë diktator dikush që shkon në balotazh në vend që të [fitojë] zgjedhjet në raundin e parë? Ky është realiteti.

Erdogan tha se nëse rizgjidhet, ai do të punojë me Biden ose këdo tjetër që merr kontrollin e Shtëpisë së Bardhë, ndërsa kritikoi SHBA-në dhe aleatët e saj për qëndrimin e tyre ndaj Rusisë, duke thënë se Perëndimi nuk po merr një "qasje të ekuilibruar" në marrëdhëniet e tij me Rusinë. Ai shtoi se Turqia ka një "marrëdhënie të veçantë" me presidentin rus Vladimir Putin, i cili ndihmoi në zgjatjen e marrëveshjes së grurit. Erdogan tha se politika e jashtme e pavarur e Turqisë mbështetet në lidhjet e ngushta me Moskën. "Rusia dhe Turqia kanë nevojë për njëra-tjetrën në çdo fushë të mundshme".

Ai theksoi se në rast të një tjetër mandati, asgjë nuk do të ndryshojë në politikën e jashtme dhe e motivoi këtë vendim me rezultatet e arritura deri tani.

Me autogolin që bëri kandidati presidencial i opozitës turke, Kemal Kiliçdaroglu për dëbimin e miliona refugjatëve, dhe me këtë intervistë për CNN të Presidentit turk, Rexhep Tajip Erdogan që garanton një vazhdimësi të politikës së jashtme si faktor në Lindjen e Mesme, ndërmjetës në konfliktin Rusi-Ukrainë, etj, përpara një votimi historik presidencial të raundit të dytë duket se diferenca është e qartë. Për sa kohë sa Europa dhe SHBA nuk gjejnë një tjetër zgjidhje për refugjatet e Lindjes së Mesme në Turqi, do duhet të bashkëpunojmë serish me autokratin Erodgan pas 28 majit.

Perëndimi nuk do të rrezikojë që lumenj refugjatësh të derdhen në dyert e Europës, ndaj vendet perëndimore do përgatisin vetën edhe për pesë vite të tjera të Rexhep Tajip Erdogan, ndërsa udhëheqësi turk shkon në balotazhin presidencial si favoriti i jashtëzakonshëm i cili kërkon të zgjasë sundimin e tij mbi 20-vjeçar.

Zgjedhjet vendore

# PS MERR 53 BASHKI

## Koalicioni “Bashkë Fitojmë” merr vetëm 7 bashki në total

### Rama falënderon qytetarët. Berisha: Raporti i OSBE/ODIHR evidentoi probleme madhore me zgjedhjet

Partia Socialiste ka arritur të fitojë 53 Bashki në vend, në zgjedhjet vendore që u mbajtën të dielën e 14 majit ndërsa Koalicioni opozitar “Bashkë Fitojmë” ka fituar drejtimin e 7 bashkive.

Bashkitë e fituar nga Partia Socialsite në: Kamëz, Vorë, Elbasan, Pustec, Kolonjë, Librazhd, Dropull, Tropojë, Roskovec, Libohovë, Rrogozhinë, Këlcyrë, Gramsh, Belsh, Përmet, Delvinë, Selenicë, Tepelenë, Peqin, Poliçan, Devoll, Lushnjë, Bulqizë, Mat, Klos, Korçë, Kuçovë, Sarandë, Dibër, Skrapar, Cërrik, Patos, Prrenjas, Berat, Vau i Dejës, Mallakastër, Vlorë, Konispol, Maliq, Lezhë, Dimal, Mallakastër, Divjakë, Shijak, Përmet, Pogradec, Mallkastër, Kukës, Malësi e Madhe dhe Kurbin. Kryeqyteti dhe bashkia më e rëndësishme Tirana është marrë nga PS me një fitore të thellë. Erion Veliaj fitoi me një diferencë mbi 58 mijë vota me Belind Këlliçin.

Kandidati i PS, Erion Veliaj ka marrë 54.69% (158.688 vota). Sakaq, kandidati i koalicionit "BF", Belind Këlliçi e ndjek në vendin e dytë me 34.58% (100351), me mbi 58 mijë vota diferencë. Kandidat i tretë u rendit Arlind Qori i Lëvizjes Bashkë, i cili ka marrë 4.77% të votave ose 13835 vota. Roland Bejko i PD-së ka marrë 12.388 vora ose 4.27%. Nga ana tjetër Lajla Përnaska e PDIU ka marrë 0.73% ose 2104 vota, ndërsa Marko Dajti i Frontit të Majtë ka 0.97% ose 2807 vota.

Ndërsa “Bashkë Fitojmë” ka arritur të fitojë në total vetëm në shtatë bashki Kavajë, Pukë, Has, Himarë, Memaliaj, Mirditë, Fushë Arrëz. Në Finiq fitoi partia MEGA me kandidatin Romeo Çakuli. Dyshja Berisha-Meta nuk arritën që të fitonin as në vendet e tyre të lindjes, në Tropojë dhe Skrapar, bashki këto të “veshura rozë” në këto zgjedhje vendore.



E ndërsa Partia Demokratike zyrtare nën drejtimin e Enkelejd Alibeaj që është forcë e tretë në 14 Bashkitë ku ka pasur kandidat nuk numëron asnjë fitore.

Në këto zgjedhje të drejtë vote kishin mbi 3.6 milionë qytetarë ndërsa në garë ishin 144 kandidatë.

Në 61 bashki të vendit ishin të hapura 5213 qendra votimi, ndërsa në bashkitë Kamëz, Vorë dhe Elbasan për herë të parë u mbajt votim dhe numërim elektronik.

Kryeministri, njëherësh kreu i PS-së, Edi Rama ka falënderuar sot të gjithë qytetarët që votuan kandidatët e PS-së në zgjedhjet e 14 majit.

Për herë të parë, Partia Socialiste do të drejtojë Bashkinë Shkodër me Benet Becin në krye, bashki e cila që prej vitit 1992 është drejtuar nga kandidatët e Partisë Demokratike.

Sipas rezultateve të KQZ-së, Beci kryeson me 34 470 vota dhe kan-

didati i koalicionit "Bashkë Fitojmë", Bardh Spahia me 22 769 vota.

Kryeministri deklaroi mbrëmjen e djeshme se pas kthimit nga Samiti i Liderëve të Këshillit të Europës në Islandë do të nisë turin e falenderimeve nga Shkodra, ku theksoi vendosmërinë që të bëjë një histori të re në qytetin verior në shumë dimensione.

"Unë e kam të nevojshme të shkoj sa më shpejt në Shkodër, për të nisur nga qyteti më i bekuar nga Zoti dhe më i keqtrajtuar nga robi, një tur falenderimi në të gjithë Shqipërinë", tha Rama.

Ai theksoi se duhet të bëjnë jo atë që kanë thënë, po edhe më shumë sepse Shkodra u dha jo një shans, po një besim shumë të fortë.

Rama vuri në dukje se "ky është një besim shumë i fortë që mund të kthehet në një kohë, jo shumë të gjatë në një mosbesim shumë të madh nëse ne nuk jenë në lartësinë e kësaj sfide".

"Unë i bëra një sfidë Shkodrës disa herë. Dështova disa herë. Këtë herë Shkodra më ka bërë mua dhe na ka bërë ne një sfidë më të madhe se të gjitha sfidat që ne i bëmë të marra së bashku", deklaroi Rama duke shtuar se Shkodra është kryefjala e mandatit që sapo do të nisë pas disa muajsh.

Kryetari i Komisionit të Rithemelimit të PD-së Sali Berisha reagoi sot në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve të 14 majit dhe raportin e OSBE/ODIHR.

Në një deklaratë për mediet, Berisha vlerësoi raportin OSBE/ODIHR, ndërsa theksoi se ky raport, ndonëse paraprak nxjerr në pah problematikat e zgjedhjeve, pasi, sipas tij, u shtrembërua vota e shqiptarëve.

"Farsa zgjedhore 2023 si farsa elektorale më e shëmtuar e Shqipërisë dhe Europës, po kundërmon çdo ditë e më shumë. Me këtë rast, unë vlerësoj raportin e OSBE/ODIHR, të Autoriteteve Lokale Rajonale dhe të Parlamentit Europian, të cilët dëshmuan se zgjedhësit shqiptarë votuan nën presion dhe jo të lirë. Kjo është kryefjala e këtyre zgjedhjeve, ku me presione të të gjitha llojeve, Edi Rama ndryshoi në mënyrë antikushtetuese, antiligjore, vullnetin e shqiptarëve, ndryshoi rezultatin e votimit. Raporti paraprak, ndonëse është paraprak dhe jo përfundimtar, vë gishtin në problemet më madhore të këtyre zgjedhjeve, duke filluar nga makineria shtetërore elektorale si një përbindësh shkatërrimtar i procesit zgjedhor, si një akt që krijon pabarazinë më të madhe në procesin zgjedhor, ndalet në të gjitha format antiligjore të ndërhyrjes në vullnetin e qytetarëve shqiptarë nga qeveria, nënvizon blerjen masive të votës, gjer dhe presionet e tjera të administratës mafioze, më e pranishme se kurrë në qendrat e votimit dhe procesin e votimit. Përpjekjet për të shkëputur ndonjë gjysmë fraze nga përfaqësuesit e nderuar të institucioneve më prestigjioze të vëzhgimit të zgjedhjeve në Europë, OSBE/ODIHR, Këshillit të Europës dhe Parlamentit Europian, dështuan", tha ai.

Po ashtu, Berisha tha se kësaj shëmtie elektorale, opozita me besimin më të madh do t'i përgjigjet në mënyrën më të fuqishme.

"PD ka në disponim me qindra fakte, dokumente, me të cilat Edi Rama ka ndërhyrë dhe ka ndryshuar rezultatin e zgjedhjeve. Ka me dhjetëra padi në organet të cilat janë kryekëput vegla të partisë-shtet. PD do paraqesë një raport shumë serioz pranë të gjitha autoriteteve që vëzhguan zgjedhjet në Shqipëri dhe kancelarive të vendeve mike për të faktuar në mënyrë të pakundërshtueshme dhunimin masiv të të drejtës dhe rezultatit të këtyre zgjedhjeve. Pra, kësaj shëmtie elektorale, opozita me besimin më të madh do i përgjigjet në mënyrën më të fuqishme. Ne nuk heqim dorë nga zotimi solemn që shqiptarët të votojnë të lirë", tha Berisha.

I pyetur për zgjedhjet në Shkodër, Berisha se Shkodra votoi nën pushtim të vërtetë.

"Të gjitha pollet e kundërshtarëve tanë, por dhe tonat, e nxirrnin Bardh Spahinë 14 gjer në 16 pikë përpara. Nëse mendon ti apo ndokush tjetër se tërhiqet Sali Berisha para krimit, ai sheh veshin pa pasqyrë. Unë kurrë nuk tërhiqem para bandave të krimit shtetëror dhe joshtetëror. Shkodra është shembulli më i shëmtuar, në të cilën u votua si në rrethim nga banda të Edi Ramës. Në Shkodër u përdorën sasi kolosale, dhjetëra-milionë euro dhe jam i bindur se qytetarët e Shkodrës, zgjedhën e krimit, pushtetin e krimit, nuk do ta pranojnë. Kjo është përgjigjja ime për ju", tha ai.

Gjithashtu, Berisha tha se përkundrejt kësaj stuhie të hapur për asgjësimin e opozitës, opozita qëndroi fuqishëm.

"Unë po flas qartë se kemi të bëjmë me procesin më të shëmtuar në historinë e vendit. Kemi të bëjmë me një proces ku qytetarët shqiptarë nuk votuan të lirë. Mbi bazën e saj, PD dhe koalicioni do marrë të gjitha vendimet. Nuk mundet populli opozitar, një gjë u faktua, siç e patë, përkundrejt kësaj stuhie të hapur për asgjësimin e opozitës, opozita qëndroi fuqishëm", tha Berisha.

# Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj jep dorëheqjen

Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj, dha sot dorëheqjen nga drejtimi i PD.

Në një deklaratë në seli, Alibeaj tha se, "prej më shumë se një vit kam qenë drejtues i Partisë Demokratike. Në kohën më të vështirë të saj. Kur është vënë në pikëpyetje mbijetesa e partisë që solli pluralizmin në Shqipëri. Mbijetesa e partisë së të djathtëve shqiptarë. Mbijetesa e partisë perëndimore dhe euroatlantike. Shifrat e proporcionalit tregojnë që Partia Demokratike arriti ta kalojë këtë sfidë, arriti të mbijetojë dhe tani mund të shohë drejt së ardhmes".

"Zgjedhjet e 14 Majit sollën monizëm pushteti – Rama i mbajti thuajse të gjitha bashkitë që katër vjet më parë i kishte marrë pa kundërshtarë. Para një viti, kur e prita në zyrë Sali Berishën, i thashë se më të në krye, demokratët nuk kanë asnjë shans të vijnë në pushtet. Prandaj nuk mund ta ndiqja. Prandaj nuk e ndoqa dhe zgjodha rrugën e qëndresës. Me këtë rast dua t'u shpreh konsideratën dhe mirënjohjen time të gjithë atyre demokratëve që e vendosën fatin e partisë, të familjes sonë politike, para llogarive dhe pazareve të ngushta e mediokre. Në kohë të vështira duhen njerëz me karakter të fortë. Këtë ju e keni dëshmuar", tha ai.

"Zgjedhjet e 14 Majit, pa dyshim, patën probleme serioze: presione mbi administratën, përdorim të fortësh, përdorim oligarkësh,




sistem elektronik difektoz etj. Por, para së gjithash, ne duhet të shohim nga vetja. Ne duhet të analizojmë me seriozitet efektet e përçarjes së Partisë Demokratike në rezultatin e zgjedhjeve. Ne duhet të vlerësojmë si duhet punën e bërë në terren nga strukturat e partisë, impenjimin e gjithsecilit, kontributin e gjithsecilit, për të kuptuar çfarë shkoi keq dhe çfarë shkoi si duhet", u shpreh ai.

"Në shenjë reflektimi dhe përgjegjshmërie, kam vendosur të largohem nga drejtimi i partisë dhe po ashtu nga pozicioni drejtues në grupin parlamentar. Partia duhet të riorganizohet në mënyrë kapilare, në bazë të parimeve demokratike, siç e kam theksuar vazhdimisht gjatë fushatës elektorale. Partia duhet të ketë rregulla të reja, parime të reja, për t'u ndarë nga e kaluara berishiste dhe për të ndërtuar një aleancë me potencial për 2025-ën", theksoi Alibeaj.

"Ne do të duhet të kuptojmë se si t'u flasim jo vetëm demokratëve, por edhe atyre qytetarëve të zhgënjyer nga politika e 30 viteve, të cilët përbëjnë shumicën e heshtur në vend. Këtë, megjithatë, nuk mund ta bëjë një njeri i vetëm – qoftë ky edhe drejtuesi.

Unë po largohem për t'i hapur rrugën një drejtimi kolegjial të partisë, në këtë fazë që hedh themelet për të ardhmen. Ka qenë një vendim i Kryesisë që vendosi që pozicionin drejtues, ta mbaja deri pas zgjedhjeve vendore. Tashmë që zgjedhjet përfunduan, po largohem nga drejtimi dhe do të vazhdoj të ushtroj detyrën time dhe përgjegjësinë ndaj demokratëve, si nënkryetar dhe pjesë e Kryesisë së Partisë Demokratike", u shpreh ai.

"Këtë vit që e kam drejtuar partinë kemi pasur disa arritje për të cilat jam krenar. Ne nuk kemi lejuar që Partia Demokratike të zhbëhet. Ne nuk kemi lejuar që Partia Demokratike të shkojë drejt Lindjes. Ne nuk kemi lejuar që Partia Demokratike të shkojë në rrugën qorre të antiamerikanizmit", tha Alibeaj.

"Gjithashtu, ne kemi mësuar të flasim lirisht. Ne kemi mësuar të themi të vërtetën. Ne kemi kuptuar që PD duhet të jetë e djathtë, duhet të jetë demokratike, duhet të jetë euroatlantike, sepse e tillë lindi dhe ky është misioni ynë. Kam njoftuar mbledhjen e Kryesisë të premten në orën 12:00", përfundoi Alibeaj.

# Si e humbi Biden Ballkanin



Një artikull i "Foreign Policy" tregon sesi presidenti amerikan Joe Biden po humb 'territor' në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Teksa flet për Shqipërinë, 'Foreign Policy' sjell mendimin e ish-studiuesit dhe ish-diplomatit amerikan Daniel Serwer, i cili pretendon se SHBA po shkon drejt politikave të gabuara, duke vënë në dukje rolin e Shqipërisë.

Serwer thotë se Shqipëria dhe Kroacia kanë të njëjtin synim si Serbia, të kontrollojnë bashkatdhetarët e tyre në Kosovë dhe Bosnjë, por jo si një ambicie të madhe.

"Ata janë mbështetur te Serbia si vendi kryesor në rajon për të sjellë stabilitet, në bashkëpunim me Kroacinë dhe Shqipërinë. Por Serbia është një fuqi revizioniste. Ajo dëshiron të sundojë të gjithë serbët në rajon. "Kroacia dhe Shqipëria kanë ambicie më të vogla, por në të njëjtin drejtim: të kontrollojnë bashkatdhetarët e tyre në Bosnjën dhe Kosovën fqinje", tha Serwer.

Deri në çfarë mase Shqipëria është pjesë e këtij triumvirate (aleance e tre personave), mbetet e diskutueshme, por pak vëzhgues të sprovuar vënë në dyshim qendrën e Serbisë dhe Kroacisë në skemë.

Nga parashikimet e panumërta për efektet e pushtimit rus të Ukrainës në shkurt 2022, një nga më të spikaturat në Ballkanin Perëndimor – kufiri tjetër i madh gjeopolitik i Evropës – ishte shpresa se do të shënonte fundin përfundimtar të iluzioneve perëndimore për mundësinë e akomodimi me regjimet autoritare dhe shoviniste.

Artikulli i referohet Serbisë si "një shtet satelit i Kremlinit që mbjell mosmarrëveshje përmes një rrjeti përfaqësuesish rajonalë me qëllim të zgjerimit të makinacioneve të saj pothuajse perandorake dhe, në koordinim me Moskën, të bllokojë aspiratat për anëtarësim në NATO dhe BE të Bosnje-Hercegovinës, Kosovës dhe Mali i Zi".

Shtetet e Bashkuara, edhe më shumë se BE-ja, kanë thelluar në mënyrë agresive angazhimin e tyre me presidentin gati autokratik të Serbisë, duke riorientuar njëkohësisht qëndrimin e tyre më të gjerë rajonal drejt qendrës së Beogradit dhe prioriteteve të tij politike. politikë e jashtme.

## 100-VJETORI I KOMUNITETIT MYSLIMAN SHQIPTAR

# Presidenti Begaj: Bashkësia Islame e Shqipërisë kontribuese për Pavarësinë e Shqipërisë dhe gur konsolidues të shtetit Shqiptar



Presidenti i Republikës, Bajram Begaj mori pjesë sot në pritjen me rastin e 100-vjetorit të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Duke vlerësuar kontributin e Komunitetin Mysliman, Presidenti Begaj tha se, "në këto 100 vite të veprimtarisë së tij, Komuniteti Mysliman ka dëshmuar se, shërbimi ndaj kombit dhe ndaj besimit janë vlerë dhe mision".

"Kushdo njeh historikun e Komunitetit Mysliman Shqiptar, preket nga thelbi dhe karakteri patriotik që qëndron në themel të formimit të këtij institucioni. Sot është rasti të rikujtojmë faktin se bashkësitë fetare, ndër to dhe Bashkësia Islame e Shqipërisë janë kontribuese të rëndësishme për Pavarësinë e Shqipërisë dhe gur konsolidues të shtetit shqiptar. Organizimi i besimtarëve myslimanë, që përbënin shumicën e popullsisë së vendit, në një institucion mbi baza kombëtare, krejtësisht shqiptar dhe të mëvetësishëm nga institucionet fetare të huaja është tregues sesa i rëndësishëm dhe i shenjtë ishte për klerikët dhe myslimanët shqiptarë pavarësia dhe sovraniteti edhe në kuadrin fetar. Si fryt i përpjekjeve të kahershme të klerikëve myslimanë shqiptarë, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka dëshmuar ndër vite se feja dhe kombi për ta ka qenë dhe është i pandashëm si dy nocione që nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Në veprimtarinë e tyre, ata u përkujdesën për ruajtjen e kohezionit social me besimet e tjera, të vetëdijshëm se ruajta e harmonisë brenda popullsisë me shumë besime në një shtet të 'brishtë', ishte domosdoshmëri jetike për kombin", tha Kreu i Shtetit. Në vijim, Begaj tha se, "Komuniteti Mysliman, si komuniteti më i madh, kishte përgjegjësinë por dhe meritën për këtë imperativ të kohës".





# Kryeministri Rama dhe Ambasadorja e SHBA-së, Kim marrin pjesë në nisjen e stërvitjes ushtarake

# “DEFENDER EUROPE 2023”

## Rama: Jemi më lart se kurrë në respektin ndërkombëtar!




Stërvitja ushtarake “Defender Europe 2023” nisi ditën e sotme në Shqipëri, ndërsa solli në vendin tonë 24 mijë trupa të NATO-s dhe SHBA-së që deri më datën 22 qershor do të kryejnë stërvitje ushtarake në vendin tonë. Nisja e kësaj stërvitjeje u kremtua me një ceremoni të veçantë në sheshin ‘Nënë Tereza’, ku u ekspozuan mjete ushtarake, e ndërsa të pranishëm ishin Presidenti Barjam Begaj, kryeministri Edi Rama, ambasadorja Yuri Kim, ministri Niko Peleshi. Këtë stërvitje kryeministri Edi Rama e cilësoi si një pikë kulmore për vendin tonë në arenën ndërkombëtare.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Arben Kingji, në fjalën e tij në ceremoninë e hapjes së stërvitjes Defender Europes 2023 tha se kjo stërvitje tregon vëmendjen e NATO për të qenë bashkë në sfidat.

“*Faleminderit për praninë tuaj në këtë ditë të veçantë për hapjen e stërvitjesh, në veçanti falënderim për aleatin tonë strategjik SHBA-të. Defender Europe 23 është një stërvitje që drejtohet nga SHBA, e cila qëndron qartazi angazhimin e SHBA dhe NATO-s si mbrojtës të demokracive. Të qëndrojmë së bashku kundër kërcënimeve të mundshme, dëshmi e fuqisë së bashkëpunimit dhe unitetit. Kjo stërvitje na mundëson forcimin e kapaciteteve tona. Mesazh për kundërshtarët tanë të mundshëm që ne jemi të përgatitur dhe të bashkuar për të përballuar sfidat e përbashkëta*”, tha Kingji.

Kryeministri Edi Rama përshëndeti sot nisjen në Shqipëri të stërvitjes së përbashkët shumëkombëshe, drejtuar nga Komanda Evropiane e SHBA-së “Defender 2023”, ku do të demonstrohen aftësitë ndërvepruese të Shteteve të Bashkuara me ushtritë aleate dhe partnere të NATO-s.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, Rama u shpreh se, organizimi për herë të dytë në Shqipëri i stërvitjes më të madhe ushtarake në Evropë është një privilegj i posaçëm për Forcat e Armatosura të Shqipërisë, të cilat janë pritëse dhe pjesëmarrëse të kësaj stërvitjeje.

Rama vlerësoi se, organizimi i "Defender 2023" për herë të dytë në Shqipëri vë në pah edhe përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve tona ushtarake, falë edhe mbështetjes së paçmuar të aleatëve tanë amerikanë dhe aleatëve të tjerë të vendeve të NATO-s.

"Shqipëria nuk ka qenë kurrë më lart në nivelin e respektit ndërkombëtar dhe sot, e ulur në tryezën e Këshillit të Sigurimit krah për krah me SHBA-të si bashkëpenëmbajtëse për çështjen e Ukrainës, ajo merr një profil dhe një rol, që jo vetëm e ngarkon me përgjegjësi të jashtëzakonshme, por edhe e vë në dukje se çfarë përparimi dhe çfarë pjekurie ka arritur vendi ynë", shtoi Rama.

Kryeministri theksoi se, zhvillimi i kësaj stërvitje me praninë e trupave shumëkombëshe nën drejtimin e SHBA-së, është shprehje e unitetit të madh dhe vendosmërisë së palëkundur të gjithë komunitetit euroatlantik për të mbrojtur me çdo kusht vlerat dhe parimet mbi të cilat ngihen shoqëritë tona. "Stërvitja na kujton se pavarësisht gjuhës që flasim e flamurit që përfaqësojmë, jemi të lidhur pazgjidhshmërisht me ato vlera e parime që janë të kërcënuara po njësoj për secilin prej nesh. Të gjithë së bashku jemi të imponuar nga historia jonë dhe ardhmëria jonë që të funksionojmë në unitet të plotë", theksoi Rama.

Presidenti Begaj ka përshëndetur stërvitjen Defender 2023. Kreu i shtetit e cilësoi si një sfidë të cilën Shqipëria ja ka dalë të triumfojë. Më tej



## Kryeministri Edi Rama

*"Shqipëria nuk ka qenë kurrë më lart në nivelin e respektit ndërkombëtar dhe sot, e ulur në tryezën e Këshillit të Sigurimit krah për krah me SHBA-të si bashkëpenëmbajtëse për çështjen e Ukrainës, ajo merr një profil dhe një rol, që jo vetëm e ngarkon me përgjegjësi të jashtëzakonshme, por edhe e vë në dukje se çfarë përparimi dhe çfarë pjekurie ka arritur vendi ynë"*

ai inkurajoi të rinjtë të bëhen pjesë e mbrojtjes dhe sigruisë së vendit të tyre,"Dy vite me parë, kur nisëm punën për stërvitjen Defender Europe 2021, e dinim se sfida ishte tepër e madhe për kapacitetet e vendit tonë. E megjithatë ne arritëm të tregojmë se dimë të ngrihemi me përgjegjshmëri në lartësinë e detyrës dhe se Shqipëria jonë e vogël, në fakt, rreh më shumë se pesha e saj. I dashur Gjeneral Wickmann, Më vjen shumë mirë, që mblidhemi përsëri në Shqipëri, për t'ju konfirmuar edhe njëherë mbështetjen tonë të palëkundur dhe gatishmërinë e vendit tonë për të intensifikuar gjithmonë e më tej bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Defender Europe lindi si një stërvitje për të rritur kapacitetet mbrojtëse të Aleancës në rast konflikti a kërcënimi. Me agresionin e padrejtë rus në Ukrainë, realiteti i sotëm gjeopolitik është tërësisht ndryshe nga ai i dy viteve më parë dhe situata e sigurisë është bërë tejet më komplekse. Këto ndryshime kanë efekte të ndjeshme edhe në rajonin tonë të brishtë të Ballkanit Perëndimor, ku aktorë dashakeqës që nuk ndajnë të njëjtat vlera me ne, përpiqen të zgjerojnë influencat e tyre. Prandaj dhe rëndësia e kësaj stërvitje është sot më e prekshme se kurrë dhe vazhdueshmëria e saj më se e nevojshme.

Shqipëria është e përkushtuar në misionin e saj si faktor stabilizues ne Ballkan dhe eksportuese e



sigurisë në rajon e më gjerë. Padyshim meritat për këtë i takojnë secilit prej burrave dhe grave në uniformë që shërbejnë në Forcat tona të Armatosura dhe nderojnë dhe lartësojnë çdo ditë flamurin e Shqipërisë. Ju jeni një shtyllë e rëndësishme e shoqërisë sonë dhe mirënjohja për angazhimin dhe profesionalizmin tuaj nuk mund të shprehet mjaftueshëm. Unë ndihem krenar, që kam qenë njëri prej jush; e në pozitën time si Komandant i Përgjithshëm inkurajoj qeverinë të shtojë akoma




më shumë mbështetjen për Forcat e Armatosura dhe kontributin e Shqipërisë në NATO.
Çdo investim më shumë drejt forcimit të kapaciteteve mbrojtëse, është një investim më shumë drejt stabilitetit; është një investim për të garantuar një të ardhme më të paqtë të brezave të rinj, të cilët kurrësesi nuk duhet të përballen me pasojat shkatërruese që sjellin konfliktet. Koha për të marrë përgjegjësitë tona është tani dhe reagimi duhet t'i përgjigjet sfidave aktuale. Ju faleminderit të gjithëve për përkushtimin. Kur të rishihemi përsëri pas dy vitesh për Defender Europe 2025, uroj vetëm që situata globale e sigurisë të jetë më e qetë, sepse nuk kam pikë dyshimi, që Shqipëria do vazhdojë gjithnjë të mbrojë vlerat e paqes dhe unitetit, duke qëndruar gjithnjë krah-për-krah Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të tjerë të NATO-s. Zoti bekoftë Shqipërinë dhe miqtë tanë!'- tha Begaj.

Ambasadorja Yuri Kim ishte e pranishme në aktivitetin për nisjen e stërvitjes ushtarake Defender 2023. Yuri Kim tha se kjo stërvitje tregon se SHBA së bashku me vendet aleate mund të kryejnë çdo mision. Kim citoi edhe fjalët e Skënderbeut, duke thënë se bashkimi bën fuqinë.
“Ky është një moment i jashtë, jemi me fat që kemi këtu, në një shesh të përdor nga një diaktat brutal i përkushtuar për ta izoluar Shqipërinë nga bota, shqiptareve u tha se SHBA ishin armiqtë e tyre. Shikoni përreth jush, një Shqipëri e ndryshuar dhe kjo është historike, ja ku jemi në një Shqipëri demokratike, të rrethuar nga burra dh egra me uniformë nga SHBA Shqipëria e partnerët ndërkombëtare, jemi këtu si aleat miq dhe partner, amerikanë dhe shqiptarë që qëndrojnë krah për krah, dikur të ndarë veçmas, tani aleatë të NATO-s dhe partnerët më të afërt ushtarak. Në dy vite që prej Defender 2021, bota ka ndryshuar, Shqipëria dhe aleatët tanë të NATO-s janë më të bashkuar dhe më të fortë se kurrë. Nuk mund të mos kujtoj fjalët e Skënderbeut, bashkimi bën fuqinë. Që nga Defender 2021, Shqipëria dhe ShBA po bëjnë më shumë se kurrë më parë së bashku. Kemi ngritur dy pranitë e para ushtarake të ShBA në historinë e Shqipërisë. Defender 2023 do të na tregojë se së bashku me aleatët dhe partnerët ne mund të kryejmë çdo mision, për burrat dhe gratë me uniformë ju falënderoj për shërbimin që zgjidhët të mbroni vendin tuaj, të na mbroni ne. Jemi krenar që e quajmë Shqipërinë aleate dhe mike”, tha Kim.

Tensionet në veri të Kosovës

# BE: Të dyja palët përgjegjëse për dhunën. Dialogu është më i rëndësishëm se kurrë

## DËSHTON PËRPJEKJA PËR NJË TAKIM KURTI-VUÇIÇ NË BRATISLAVË



Zëdhënësi i BE-së për çështje të jashtme dhe të sigurisë, Peter Stano, tha se dhuna në veri të Kosovës "ka ardhur nga të dyja palët", duke iu referuar Kosovës dhe Serbisë.

Nga përleshjet mes protestuesve serbë dhe ushtarëve të KFOR-it, të hënën në Zveçan, mbetën 35 ushtarë të plagosur, ashtu si edhe më shumë se 50 protestues.

*"Eskalimin e shohim që nga e premtja, prandaj edhe [shefi i politikës së jashtme të BE-së, Joseph] Borrell dhe vendet anëtare [të BE-së] e kanë dënuar dhunën dhe kanë ftuar për uljen e tensioneve. U kanë thënë të dyja palëve", tha Stano për gazetarët në Bruksel.*

*"Kjo situatë nuk ka ardhur vetvetiu, por është pasojë e rrethanave dhe zhvillimeve, për të cilat janë përgjegjëse të dyja palët", shtoi ai.*

*Në pyetjen e gazetarëve se a do të thotë kjo situatë se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi ka dështuar, Stano tha: "Jo, dialogu vazhdon, përpjekjet madje janë shtuar dhe dialogu është më i rëndësishëm se kurrë".*

*Shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell ka reaguar për situatën në veri të Kosovës duke i kërkuar Kosovës që të shtensionojë menjëherë situatën.*

*Pasi BE dënoi dhunën në Zvecan ku u përplasën protestuesit serbë me forcat e KFOR, Borrell qëndron në të njëjtën linjë duke thënë se aktet janë të papranueshme.*

*"Aktet e dhunshme, të kryera ndaj trupave të KFOR-it, mediave, civilëve dhe policisë janë absolutisht të papranueshme.*

*BE-ja u kërkon autoriteteve të Kosovës dhe protestuesve që menjëherë dhe pa kushte të ndalin përshkallëzimin situatën. Ne presim që palët të veprojnë me përgjegjësi dhe të gjejnë menjëherë një zgjidhje politike përmes dialogut", shkroi Borrell në Twitter.*

**Përpjekja për një takim Kurti-Vuçiç në Bratislavë**

*I dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, Mirosllav Lajçak, është duke bërë përpjekje të organizojë një takim 'ad hoc' mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç, në Bratislavë, mëson Radio Evropa e Lirë nga burimet diplomatike në Bruksel.*

*Sipas tyre, "kjo është ende një ide dhe një përpjekje" dhe "nuk ka konfirmime nga palët nëse janë apo jo të gatshme për një takim të tillë".*

*Bratislava është përmendur si vend i mundshëm për takim, pasi dy udhëheqësit janë të ftuar të marrin pjesë në një konferencë për sigurinë globale që po zhvillohet në këtë vend.*

Megjithate Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq ka njoftuar anullimin e kteij udhetimi ne Bratislave.

Ai tha se po anulon qëndrimin e tij dyditor në Bratislavë,

sepse siç tha ai, për të është më e rëndësishme të jetë me njerëzit e tij.
“Dhe sot do të vizitoj ushtarët tanë, heronjtë, disa mijëra prej tyre që janë të dislokuar në vendet më të rëndësishme. Jam i bindur se e vërteta dhe drejtësia dhe Serbia do të fitojnë në fund”, ka shkruar Vuçiq në një postim në Instagram.

**Anulohet stervitja e Defender 23 në Kosovë**

Ministria e Mbrojtjes e Kosovës njoftoi se, për shkak të situatës në veri të Kosovës, aktivitetet e parapara për sot në kuadër të ushtrimit ndërkombëtar “Defender Europe ’23”, anulohen.
Detaje të tjera nuk u dhanë.
Nga 21 maji, Kosova është bërë nikoqire e stërvitjeve më të mëdha ndërkombëtare në rajonin e Ballkanit, “Defender Europe 2023”, [Mbrojtësi i Evropës 2023].
Është paraparë që këto stërvitje të zgjasin deri më 2 qershor dhe në to të marrin pjesë mbi 1.300 ushtarakë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, së bashku me 24.000 ushtarakë të 25 vendeve të NATO-s.
Që nga e premtja, serbët në veri të Kosovës janë duke protestuar kundër kryetarëve të rinj të dalë nga zgjedhjet e 23 prillit.
Dje (e hënë), protestuesit me maska e edhe ata pa maska kanë ushtruar dhunë ndaj pjesëtarëve të KFOR-it, Policisë së Kosovës dhe gazetarëve. Ata kanë hedhur gjësende të ndryshme në drejtim të paqeruajtësve, derisa kanë dëmtuar vetura të mediave, duke e djegur tërësisht veturën e një televizioni.
Si pasojë e protestave të dhunshme një ditë më parë, u plagosën 30 ushtarë të KFOR-it.

# BE pret që Mali i Zi të fokusohet në reformat drejt integrimit




Bashkimi Evropian pret që udhëheqja e re e Malit të Zi të fokusohet në reformat kryesore që janë të nevojshme për përparimin e vendit në procesin e integrimit evropian.
Zëdhënësja e Komisionit Evropian Ana Pisonero konfirmoi se institucionet evropiane janë të gatshme të bashkëpunojnë me Malin e Zi dhe të gjithë aktorët politikë për të ndihmuar vendin të qëndrojë në rrugën e tij strategjike dhe të ndërtojë një konsensus mbi veprimet prioritare që janë kyçe për procesin e pranimit të vendit në BE.
“Përqendrimi në reformat urgjente të shtetit të së drejtës, të cilat janë renditur në raportin e fundit të Komisionit Evropian për zgjerimin, janë të një rëndësie kyçe. Sigurisht, për këtë qëllim, ne vazhdojmë të mbështesim Malin e Zi në rrugën e tij drejt anëtarësimit në BE. Për ne, stabiliteti politik është kyç për përparimin në rrugën drejt BE-së, një proces ng ai cili përfiton si Mali i Zi, ashtu edhe Evropa në tërësi”, tha Pisnero në një konferencë shtypi në Bruksel.
Ajo konfirmoi se pret që së shpejti në Bruksel të organizohen takimet e para të nivelit të lartë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe presidentit të sapozgjedhur, Jakov Milatoviq.
Jakov Milatoviq u inaugurua më 20 maj, pasi mposhti Milo Gjukanoviqin, i cili mbante postet më të larta në Mal të Zi për tre dekada.
Vizita e tij e parë jashtë vendit pritet të jetë në Bruksel.
Milatoviq do të marrë pjesë në samitin e Komunitetit Politik Evropian, i cili do të mbahet më 1 qershor në Kishinjev të Moldavisë.
Nuk përjashtohet mundësia që ai të vizitojë Brukselin përpara Kishinjevit për të konfirmuar angazhimin e tij ndaj integrimit evropian.
Mali i Zi konsiderohet lider në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe ka hapur të gjithë kapitujt në negociatat për anëtarësim.
Megjithatë, nuk ka pasur asnjë konferencë ndërqeveritare që nga dhjetori 2021 për shkak të progresit të pamjaftueshëm në reformat e nevojshme në procesin e anëtarësimit.

**Dear readers and followers of Argumentum.al**

On the third anniversary of the founding of the online media Argumentum.al, now it comes in the version of a monthly magazine which you can browse online from April 2022.

This monthly publication offers a clear combination of news on Albania, the Western Balkans and the world, as well as opinions and analyses of events taking place during the month.

Thanking each of you for your attention and trust in our media, we promise that we will continue to publish objective analysis on key developments in the country, region, Europe and the world.

Argumentum.al strives to be an authoritative source of journalism with analyses and comments on international relations, world politics and a wide range of issues of global importance by publishing exclusive materials. This is done thanks to the contribution of some of the well-known names of Albanian politics and journalism and other local and foreign collaborators. At the same time, Argumentum.al is open for comments and opinions by its readers.

Read on domestic and international issues in the magazine Argumentum.al free of charge in Albanian and English!

***"Argumentum", an intellectual process…***



# "English Edition"

# "Class reading" in Brussels!! Long live the King! Zelenski opens up, Putin isolated! "Political tremor in Tirana but not in Turkey!

REALPOLITIK "FLASH" | 1 – 16 MAY 2023 | EXCLUSIVELY AT ARGUMENTUM

## Grand Master Dr. Jorgji KOTE « dots the « I's» and crosses the "t's » on 4 major events in only 1000 words

DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*



1. **"Class reading" in Brussels!** It was the Meeting between the Serbian President Vuçiç and Kosovo's Prime Miwister Albin Kurti in Brussels on 2 May. It was simply a reading of the draft on the Association of the communes with Serbian majority prepared by a Serbian team of 4 persons. Certainly after "Serbian mood"; without noone in Pristina knowing how and on what criteria it was drafted, without having the opportunity tw throww even a glance before heading to Brussels. As expected, PM Kurti rejected it. But Lajçak and Borrell were happy since they satisfied Vuçiç desire to submit the draft there although they knew the "NO"!

Thus, this that meeting failed, the fourth in succession within the first 45 days after the nonsigned agreement in Ohrid. The first occurred on 24 April in the partial local elections in the Northern Kosovo with the record low turn over of 3 pwr cent; on 25 April in the high level meeting in Strasbourg where Serbia rejected the proposal for Kosovo's accession to the Council of Europe and the third one in New York on 26 April where Belgrade sworn with a loud voice that it will never, never recognize Kosovo and permit it to become UN Member, since it is and will remain part of Serbia! They recognize Ohrid only for the sake of Association, to have it as "Nastradini's nail" for their gloomy future plans against Kosovo.

As we have previously underlined, the only viable solution for the Asociation is that both sides, with the US and EU support should agree in principle that it should not have executive power and create a state within the state. The very relevant pattern is the one between Serbia and Croatia; so there is no need to "search for a needle in a straw". When they agree "in spirit", then it is much easier for "the letters"; experts of both sides would sit down and draft the wording. Otherwise, both sides will be "beating about the bush", the



“class reading” will continue and things may be postponed in the Greek calendas.

**2. Long live the King!** This was the great message that London conveyed on the 6th of May in the Ceremony for the Coronation of King Charles III, 7 decades after his Mother, the emblematic Queen Elisabeth II. A royal dignified ceremony in all respects, radiating another brilliant image worlwide. Despite problems, shadows and suspicions, that ceremony and the new King that with his starting stances has gained more popularity shows that constitutional monarchies remain a preferred option for the British an other countries where they are well – established. They and their crowns, with Prince William&Kate as the best pattern are democratizing and modernizing monarchies, bringing them closer to the people also thanks to numerous telling projects and programs and for many other convincing reasons. If Presidents of Republics, even those elected by the people would have provided better examples, ok, but the reality shows the opposite. Not to mention how much the political establishments “suffer” for their election once in five years! This is why the British and others worldwide were right to celebrate and chant “Long live and God save the King”!

> **Long live the King!**
>
> *This was the great message that London conveyed on the 6th of May in the Ceremony for the Coronation of King Charles III, 7 decades after his Mother, the emblematic Queen Elisabeth II. A royal dignified ceremony in all respects, radiating another brilliant image worlwide.*



**3. Zelenski opens up, Putin isolated!** President Zelenski showed this once again with his official visits and meetings during 13 – 15 May in Rome, Germany, Paris and London. In all these 4 states it was vigorously confirmed the multi-faceted support for Ukraine. Certainly this visit was more prosperous in Germany, given its major political, economic and military weight and debates concerning its delivery of heavy weapons to Ukraine, due to Germany’s hesitations and delays. After his meetings with Chancellor Scholz, President Steinmeier and his thanks in German “Danke Deutchland” their bilateral relations embarked on a new epoch. Besides, Zelenski was awarded with the highest german Prize “Charlemagne” or “Charles the Great” Above all, Zelenski in this visit ensured a new package of assistance amounting to 2,7 Billion Euro for the delivery of Leopard tanks, ammunition and sophisticated anti- air defence systems. Now Germany is the second largest supplier for



Ukraine after USA. What a big jump when one think that only a year ago Germany started with only 5.000 helmets which was ridiculed at that time! This new tour by President Zelenski proved once again that He and Ukraine are gaining growing acknowledgment and support abroad. The opposite occurs with Russia and Putin. The latter with an exception of a quick visit in occupied areas in Ukraine, cannot leave even Moscow, since no one invites him and due to fear of the international arrest warrant.

## 4. Political tremor in Tirana but not in Turkey!

14 May found both Tirana and Turkey in elections. Although in Albania they were just municipal and not political, for many well-known reasons they were equally, if not more important than parliamentary elections; especially this time to see the genuine power of the opposition, after their boycott of these elections in 2020.

However, they cannot be compared to the presidential and parliamentary elections in Turkey, due to the exceptional turkish political, economic and military role worldwide. But also due to the fact that President Erdogan has been in power for 21 years now with all well-known problematics and concerns. With a declining economy, rising inflation, and with over 50.000 victims from the devastating earthquake a few months ago. Moreover that unlike Rama in Tirana, Erdogan this time had a totally united opposition also with his former allies and promising alternatives. Nonetheless, the expected electoral tremor "shook" only Albania; where (Rithemelimi) of former President Berisha and" Together we win" suffered a real "Waterlow" even in their stronghold in Shkodra. Whereas in Turkey, Erdogan and Kilicdaroglu are running "neck to neck" and will fight again on 28 May. Despite Erdogan's "democratic sins and deficits" the united turkish opposition even this time did not beat with ballots Erdogan neither in the Parliament, where he has a comfortable majority nor as a President. He is 5 per cent before his challenger and so we have to keep the breath until 28 May to see who will be the next Turkish President and whether there would be an electoral tremor in Turkey!



# NATO soldiers clash with Serb protesters in Kosovo, Russian FM warns a big explosion is looming in the heart of Europe

*29 May*



NATO-led peacekeepers on Monday dispersed Serb protesters who again clashed with police in northern Kosovo to demand the removal of recently elected Albanian mayors, as ethnic tensions flared in the Balkan nation, reported AFP.

Kosovo's Serbs had boycotted last month's elections in the northern towns, which allowed ethnic Albanians to take control of local councils despite a minuscule turnout of under 3.5 percent of voters.

Kosovo's Prime Minister Albin Kurti officially installed the mayors last week, defying calls to ease the tensions by the European Union and the United States, which have both championed the territory's 2008 independence from Serbia.

Early Monday, groups of Serbs gathered in front of the municipal building in the Serb-majority town of Zvecan and tried to force their way into the building.

Many Serbs are demanding the withdrawal of Kosovo police forces — whose presence in northern Kosovo has long sparked resistance — as well as the ethnic Albanian mayors they do not consider their true representatives.

Police responded with tear gas and pushed them back, according to an AFP journalist at the scene.

NATO-led peacekeepers in the KFOR mission at first tried to separate protesters from the police, but later started to disperse the crowd using shields and batons, an AFP journalist saw.

Several protesters replied by hurling rocks, bottles and Molotov cocktails at the soldiers, but were quickly repelled a few hundred meters away from the Zvecan municipal building.

Kosovo police said "organised" demonstrators also threw tear gas in northern Kosovo towns, home to many ethnic Serbs who reject Kosovo's independence from Serbia, which it proclaimed in 2008.

"The protesters, using violence and throwing tear gas, tried to cross the security cordons and make a forced entry into the municipality facility," Kosovo police said in a statement.

"Police were forced to use legal means, such as (pepper) spray, to stop the protesters and bring the situation under control."

KFOR said in a statement, "We call on all sides to refrain from actions that could inflame tensions or cause escalation."

In the meantime it is reported that Belgrade has responded to the tension by placing its army









on high alert and ordered forces towards the Serbian border with Kosovo.

Russia's foreign minister Sergei Lavrov, speaking on a visit to Kenya, said that "Serbs are fighting for their rights in northern Kosovo".

"A big explosion is looming in the heart of Europe, where NATO in 1999 carried out an aggression against Yugoslavia," Lavrov said, referring to the 1999 NATO intervention against Belgrade that effectively ended the war between Serb forces and ethnic Albanian fighters.

The US ambassador and European Union envoy have summoned the ethnic Albanian mayors to a meeting in the Kosovo capital of Pristina in a bid to ease tensions.

Two media teams from Pristina reported that protesters had slashed their tires and spray-painted their vehicles, while a local journalists' association called on law enforcers to provide a safe working environment for the media.

It is reported that Serbs also attacked cars of Albania's TV teams reporting from the scene.

## Rama calls for an end of the threatening absurdity in the north of Kosovo



*Prime Minister Edi Rama declared on Thursday that the conflict in the north of Kosovo must be resolved side by side with the democratic world.*

*Rama published images during the meeting he held with the president of the EU Commission, Ursula von der Leyen, the Dutch prime minister, Mark Rutte, and the Serbian president, Aleksander Vucic, in Moldova on social networks.*

*"The region must enter into a new relationship with the EU, while the conflict in the North of Kosovo must be resolved side by side with the democratic world, putting an end to the threatening absurdity and finalizing the normalization and mutual recognition agreement between Kosovo and Serbia," said Rama in his post.*

*Rama participated in the meeting of the European Political Community (EPC) on Thursday. This meeting was held in Chisinau, Moldova, where around 50 European leaders discussed the security and energy issues of the continent.*

# Defense Minister gives details on "Defender Europe '23" taking place in 5 military bases in Albania




*TIRANA, May 27*

The Defender Europe 23 exercise is currently taking place in 5 military bases throughout Albania, a Western Balkans country which is a member of the North Atlantic Alliance, NATO.

The Minister of Defense, Niko Peleshi, gave on Saturday details of this exercise, noting that it includes land, air and sea operations.

"The Armed Forces are showing maximum readiness and commitment. The United States, Albania and NATO are more united and stronger than ever," said Peleshi.

The "Defender Europe 2023" military exercise has brought together about 25,000 troops from 29 countries, members of NATO, but also from partner countries.

In the framework of this comprehensive training commitment Albania welcomes and conducts the "Immediate Response" and "Astral Knight" exercises on May 15 – June 9, 2023.



# NATO to send 700 more troops to Kosovo to help quell violent protests

*30 May*

NATO Secretary-General Jens Stoltenberg said Tuesday that the military organization will send 700 more troops to northern Kosovo to help quell violent protests after clashes with ethnic Serbs there left 30 international soldiers wounded.

"We have decided to deploy 700 more troops from the operational reserve force for Western Balkans," Stoltenberg told reporters in Oslo, after talks with Norwegian Prime Minister Jonas Gahr Store.

He said that NATO would also "put an additional battalion of reserve forces on high readiness so they can also be deployed if needed. These are prudent steps." A battalion typically ranges from 300 to around 1,000 troops. The NATO-led peacekeeping mission, KFOR, currently consists of almost 3,800 troops.

Earlier Tuesday, KFOR peacekeepers used metal fences and barbed wire barriers to beef up positions in a hot-spot northern town.

The troops sealed off the municipality building in Zvecan where unrest on Monday sent tensions soaring, raising fears of instability and flareup in the Balkan hotspot amid increased Western efforts to resolve a long-simmering dispute.

Kosovo is a former province of Serbia whose 2008 declaration of independence Belgrade does not recognize. Ethnic Albanians make up most of the population, but Kosovo has a restive Serb minority in the north of the country bordering Serbia.

Stoltenberg condemned the violence, saying that "such attacks are unacceptable and must stop." He warned that NATO troops "will take all necessary actions to maintain a safe and secure environment for all citizens in Kosovo."

He urged both sides to take steps to deescalate, refrain from "further irresponsible behavior," and to return to EU-backed talks on improving relations.

The United States and most European Union nations have recognized Kosovo's independence from Serbia while Russia and China have sided with Belgrade. China on Tuesday expressed its support for Serbia's efforts to "safeguard its sovereignty and territorial integrity" and Moscow has repeatedly criticized Western policies in the dispute.

Tensions first increased over the past weekend, after ethnic Albanian officials elected in



votes overwhelmingly boycotted by Serbs entered municipal buildings.

When the Serbs tried to block them, Kosovo police fired tear gas to disperse the crowd.

In response, Serbia put the country's military on the highest state of alert and sent more troops to the border with Kosovo. The Serbs protested again on Monday, insisting both ethnic Albanian mayors and Kosovo police must leave northern Kosovo.

The confrontations worsened when Serbs attempted to enter the municipal offices in Zvecan, 45 kilometers (28 miles) north of the capital Pristina.

They clashed first with Kosovo police and then with the international peacekeepers who deployed in Zvecan.

The flareup has triggered a flurry of international efforts to calm the situation.

The United States and the EU recently have stepped up efforts to negotiate an agreement between Serbia and Kosovo, fearing instability as Russia's war rages in Ukraine. The EU has made it clear to both Serbia and Kosovo that they must normalize relations if they're to make any progress toward joining the bloc.

"We have too much violence in Europe already today. We cannot afford another conflict," the EU's foreign policy chief, Josep Borrell, told reporters in Brussels on Tuesday.

He urged Belgrade and Pristina to "urgently take measures to de-escalate tensions immediately and unconditionally."

As a first step, he said, Kosovo police should suspend the operation focusing on municipal buildings in the north and violent protesters should "stand down."

In response to recent unrest, NATO has decided to increase its KFOR troops with the deployment of the Operational Reserve Forces (ORF) for the Western Balkans, a statement said, without specifying the number. Another unit will be on standby "to be ready to reinforce KFOR if necessary."

"The deployment of additional NATO forces to Kosovo is a prudent measure to ensure that KFOR has the capabilities it needs to maintain security in accordance with our UN Security Council Mandate," said Adm. Stuart B. Munsch, commander of Allied Joint Force Command Naples (JFC Naples).

A statement Tuesday by the multinational peacekeeping force known as KFOR said 30 soldiers — 11 Italians and 19 Hungarians — "sustained multiple injuries, including fractures and burns from improvised explosive incendiary devices."



Three Hungarian soldiers were "wounded by the use of firearms," but their injuries were not life-threatening, the statement added.

Serb officials said 52 people were injured, including three seriously. Four protesters were detained, according to the Kosovo police.

"Both parties need to take full responsibility for what happened and prevent any further escalation, rather than hide behind false narratives," said KFOR commander Maj.-Gen. Angelo Michele Ristuccia.

The diplomatic pace increased. Ambassadors from the so-called Quint countries — France, Germany, Italy, the United Kingdom and the U.S. — met with Kosovo PM Kurti in Pristina on Monday and Serbian President Aleksandar Vucic in Belgrade on Tuesday. Vucic later also met with the ambassadors in Serbia of Russia and China.

In a statement from his office, Vucic expressed "immense dissatisfaction and strong concern" over what he described as international "tolerance" of Kurti's actions that fueled violence against Serbs.



Urgent measures to guarantee the security of the Serbs in Kosovo are a precondition for any future talks, Vucic insisted.

Kurti has thanked KFOR troops for "valiant action to preserve peace in the face of violent extremism."

"The border between Kosovo and Serbia is one of those dangerous places where a spark could set off a fire," said Italian Defense Minister Guido Crosetto.

Russia and China both have sharply criticized Western backing for Kosovo's independence. Russia's President Vladimir Putin often has cited the "precedent" of NATO bombardment of Serbia in 1999 to justify his unlawful annexation of parts of Ukraine.

China, which has established close economic ties with Belgrade through its foreign investments, blamed the violence on a failure to respect Serbian political rights.

"We oppose unilateral actions by the Provisional Institutions of Self-Government of Kosovo," Foreign Ministry spokesperson Mao Ning said in Beijing.

The conflict in Kosovo erupted in 1998 when separatist ethnic Albanians rebelled against Serbia's rule, and Serbia responded with a brutal crackdown. About 13,000 people, mostly ethnic Albanians, died.

NATO's military intervention in 1999 eventually forced Serbia to pull out of the territory and paved the way for the establishment of the KFOR peacekeeping mission.

# ARGUMENTUM

news opinion analysis

**Adresa: Njësia bashkiake nr. 5, Rruga "Abdyl Frasheri", Ndërtesa 8, Tiranë, Shqipëri**

**Tel: +355 (0) 68 82 01 720**

**Email: redaksia.argumentum@gmail.com,**

**info@argumentum.al**

**Marketing & PR**

**Email: marketing@argumentum.al**

**Tel: +355 (0) 68 82 01 720**

**NUIS/NIPT: L91415033Q**

**...**

**Twiter : Argumentum_al**

**Facebook: argumentum.al**

**Instagram: argumentumnews**